




Infeksionet e Traktit Urinar (UTI): njihni simptomat

Informacion për të rriturit



Çfarë është UTI?

Infeksionet e traktit urinar (UTI) prekin traktin urinar, duke përfshirë fshikëzën, uretrën ose veshkat. Ndonjëherë Infeksioni i Traktit Urinar mund të shndërrohet në një infektion të rëndë, i cili mund të çojë në një përkeqësim të rëndë të gjendjes suaj dhe në raste të tilla, mund t'ju duhet të shkoni në spital.

Këto janë **disa nga simptomat që mund të përjetoni nëse keni UTI (Infeksion i Traktit Urinar):**

- **Nevoja për të urinuar më e shpeshtë,** e papritur ose më urgjente se zakonisht.
- **Dhimbje ose ndjesi djegie** gjatë urinimit.
- **Nevojë për të urinuar natën** më shpesh se zakonisht.
- **Dhimbje e re** në pjesën e poshtme të barkut.
- **Humbje e kontrollit të urinimit ose urinim i pavullnetshëm** më i rënduar se zakonisht.
- **Dhimbje e veshkave** ose dhimbje në pjesën e poshtme të shpinës.



- **Gjak në urinë.**
- **Ndryshime në sjellje,** si për shembull irritueshmëri ose konfuzion (delirë). Kjo mund të jetë një simptomë e një infeksioni të traktit urinar (UTI), por mund të shkaktohet edhe nga arsye të tjera, të cilat duhet të përjashtohen.
- **Shenja të përgjithshme të infeksionit,** si ethe, temperaturë e lartë ose ndjesi nxehtësie dhe të dridhurash, me dridhje të forta të trupit (rigore) ose të flohta.
- **Temperaturë shumë e ulët** më poshtë se 36°C.



Mund të përjetoni më pak nga këto simptoma nëse keni një kateter urinar.

Çfarë duhet të bëni nëse mendoni se keni një infektion të traktit urinar (UTI)?

Sigurohuni që të pini rregullisht mjaft lëngje për të shmangur dehidratimin.

Kontakttoni një profesionist të kujdesit shëndetësor: ai mund të jetë **Mjeku juaj i Përgjithshëm, infermieri/ja, farmacisti në komunitet, një qendër ku mund të paraqiteni pa rezervuar një takim** ose **shërbimi NHS 111**.